

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË "iProbo" SHPK

- **Mario Kola**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 18.03.1998, me kartë identiteti me nr.personal J80318050N;

i angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë **28.04.2023**, shpreh vullnetin e tij të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë "**iProbo**" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".


2. Ortakët e shoqërisë.

Ortak i shoqërisë është:

- **Mario Kola**, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 18.03.1998, me kartë identiteti me nr.personal J80318050N;

3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:




Disenjim software, duke përfshirë analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike. Testim software, këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software. Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN). Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse. Zhvillim sistemesh migrimi, këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga Abdi Toptani, Torre Drin Shopping Center, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen



në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100,00 (njëqind) lekë**.
- Kapitali ndahet në **1 (një) pjesë/kuota**.
 - Ortaku, **Mario Kola**, zotëron **100%** të kapitalit themeltar, ose 1 (një) pjesë/kuotë, me vlerë nominale **100,00 ALL (njëqind) lekë**.


7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i parë shoqërisë do të jetë:
 - **Z. Mario Kola**




9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAK

MARIO KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Mario Kola', with a long horizontal flourish extending to the left.